



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 18.09.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM NOTASH QË PËRDMËSON MARRËVESHJEN, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS SË POLICISË EVROPIANE (EUROPOL), PËR BASHKËPUNIMIN STRATEGJIK DHE OPERACIONAL, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.28/2014”

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 29.05.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr.28/2014” në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantoi projektligjin, Z. Jeton Xoxa, përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

2.0 Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr.28/2014”, ka si qëllim miratimin e amendimit të aneksit I të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, e cila është ratifikuar me ligjin nr.28/2014. Këto amendime janë propozuar në kuadër të ndryshimeve statutoire të Europol-it.

Projektligji synon përditësimin e aneksit I të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, të ratifikuar me ligjin nr.28/2014, në përputhje me nenin 25 të marrëveshjes.

Pjesë e projektaktit janë letra e drejtorit ekzekutiv të Europol-it, aneksi I, i përditësuar dhe letra konfirmuese, me anë të së cilës pala shqiptare do të japë konfirmimin për përditësimin e aneksit I.

5.0 Diskutimet në Komision :

Deputete në komision pasi u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit bazuar në pyetjeve dhe përgjigjet e marra nga përfaqësuesit e ministrive, ndalën dhe diskutuan mbi rëndësinë e përditësimit të marrëveshjes dhe ndryshimet që ajo përcakton. Përfaqësuesi i ministrisë sqaroi se përditësimi i marrëveshjes është i domosdoshëm për shkak të rritjes së numrit të veprave penale, objekt i punës së EUROPOL, si dhe sqaroi shtimin e Aneksit I të marrëveshjes. Pas pyetjes së deputetes znj. Elona Gjebrea mbi rolin e oficerit ndërlidhës, përfaqësuesi i ministrisë shpjegoi rolin aktual të oficerit ndërlidhës, dhe mënyrat e zbatimit të marrëveshjes deri më tani.

Pas shqyrtimit të projektligjit, Komisioni e votoi dhe miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

7.0 Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol), për

bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr.28/2014” është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.”

Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2,të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi , me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI